



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.04.2023

Nr: 56

Ora: 16:30

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 12, DATË 06.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

OBJEKT: Vendosja e sanksionit administrative ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Cërrik

BAZË LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kuadër të procedurave për mbikëqyrjen e procesit të raportimeve për veprimtari të publike të institucioneve shtetërore, ka konstatuar se bashkia Cërrik ka raportuar 4 veprimtari publike në ndërfaqen e KQZ-së, më datë 25.03.2023 për t'u zhvilluar në datën 30.03.2023.
2. Komisioneri me anë të vendimit nr. 213, datë 28.03.2023 ka vendosur ndalimin e zhvillimit të veprimtarive publike me datë 30 mars, me temë: a) "Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike", me vend të zhvillimit në "Shales, NJA Shales", b) "Ndërtim banese Klos", me vend të zhvillimit në "Klos", c) "Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike", me vend të zhvillimit në "Shtepanjë", ç) "Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike", me vend të zhvillimit në "Shtermen", me arsyetimin se **"aktivitetet e zhvilluara nga institucioni publik, Bashkia Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik, me pjesëmarrjen e personave partiakë përbën veprimtari të ndaluar, në kuptim të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"**.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 04.04.2023, në adresën e postës elektronike, ka marrë indicie mbi zhvillimin e veprimtarive publike nga bashkia Cërrik, kjo e fundit në dijeni të ndalimit për zhvillimin e tyre, nëpërmjet vendimit nr. 213, datë 28.03.2023.
4. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj z. Florenc Doka, si person përgjegjës për organizimin e veprimtarive publike. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se është shkelur neni 92 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2023 i Komisionit Rregullator. Komisioneri ka konstatuar se Bashkia Cërrik ka zhvilluar aktivitetet e ndaluara nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas planifikimit të raportuar në ndërfaqen e KQZ-së.
5. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të

bashkisë Cërrik në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor.

6. KAS-i caktoi me short z. Koli Bele relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 12, datë 06.04.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake të datës 11.04.2023, ora 13:30 vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 11.04.2023, ora 16:30.

7. Seanca e datës 11.04.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik i njoftuar rregullisht, nuk u paraqit në seancën e shqyrtimit.

8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr.12, datë 06.04.2023 të Komisionerit;
- Vendimin e Komisionerit nr. 213 datë 28.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik”;
- Vendimin e Komisionerit nr. 267, datë 05.04.2023 “Për shqyrtimin administrativ ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës në bashkinë Cërrik, për zhvillimin e veprimtarive publike të ndaluara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi:

1. Tipologjia e shkeljeve të konstatuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për të cilat kërkon sanksion administrativ ndaj z. Florenc Doka, si person përgjegjës për raportimin e veprimtarive

publike ka në fokus zhvillimin e tre veprimtarive publike, të cilat ishin ndaluar paraprakisht nga KQZ-ja për t'u zhvilluar, bazuar në kompetencën ligjore sipas pikës 4 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Këto veprimtari publike ishin raportuar nga bashkia Cërrrik, në respektim të afateve ligjore, si veprimtari publike me pjesëmarrës kryetarin e bashkisë, si dhe drejtuesin politik të qarkut Elbasan z. Damian Gjikhuri. Komisioneri i ka ndaluar me pretendimin se pjesëmarrja në veprimtari e personave politikë përbën "veprimtari të ndaluar".

2. Veprimtaritë publike të ndaluara përkufizohen nga neni 3 i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Sipas nënpikës 1.3 të pikës 1 të këtij neni, në listën e veprimtarive të ndaluara bëjnë pjesë:

- a) *shpërndarja në veprimtari publike e lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;*
- b) *shpërndarja në veprimtari publike e akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, çertifikatave të pronësisë, dhe çfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr.111/2018, "Për kadastrën" në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;*
- c) *vënia në dispozicion e aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit;*
- ç) *përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimi në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimi apo ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë*

ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

*d) **gjatë fushatës zgjedhore**, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat ne organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkëlqeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.*

dh) kontrollet dhe verifikimet e bizneseve tregtare dhe operatoreve në kundërshtim me procedurat ligjore dhe veprimtarinë institucionale.

3. Lista e **veprimtarive të ndaluara** është listë e numërtuar (nga “a” tek “dh”), sikurse është e numërtuar lista e **veprimtarive të ndaluara për t’u promovuar** (nga “a” tek “d”). Kjo do të thotë se llojet e veprimtarive të ndaluara dhe të veprimtarive të ndaluara për t’u promovuar sipas vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 janë të përcaktuara në mënyrë strikte. Atyre nuk mund t’u shtohen lloje të reja veprimtarie, nuk mund të pasurohen as nga Komisioneri, as nga KAS-i. Lista mund të pasurohet vetëm në rrugën e amendimit të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020. Veprimtaria “me pjesëmarrjen e drejtuesit politik” nuk bën pjesë në listën e veprimtarive sipas nënpikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3, për pasojë, nuk duhet të ishte ndaluar që të zhvillohej nga Komisioneri me shkakun se është “veprimtari e ndaluar”.

4. Mekanizimi ligjor i ndalimit paraprakisht të veprimtarive publike që përcakton pika 4 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor i jep mundësinë KQZ-së që të shqyrtojë informacionin që ka në dispozicion nga ndërfaqja e raportimeve dhe t’i japë përgjigje dy pyetjeve themelore:

a) a ka mundësi që qëllimi i veprimtarisë të jetë kapja e publikut votues (veprimtari publike)?

b) a ka mundësi që dinjitarët të përcjellin mesazh elektorale në këtë veprimtari, **duke keqpërdorur burimet shtetërore** (veprimtari e ndaluar ose veprimtari e ndaluar për t'u promovuar)?

Në rast se përgjigjia e të dyja pyetjeve rezulton pozitive, atëherë KQZ-ja është e detyruar të urdhërojë ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë. Kodi nuk kërkon që KQZ-ja të bëjë hetim administrativ për të provuar keqpërdorimin e burimeve shtetërore, nuk kërkon që KQZ-ja të provojë se keqpërdorimi i burimeve shtetërore do të jetë pasoja e vetme e mundshme e ngjarjes, në rast se lejon zhvillimin e veprimtarisë. Me formulimin “mund të përbëjë keqpërdorim” dispozita kërkon vetëm lindjen e dyshimit të arsyeshëm se zhvillimi i veprimtarisë mund të çojë në keqpërdorim të burimeve shtetërore. Linja e mbajtur nga Kodi udhëhiqet në këtë rast nga moto “më mirë një veprimtari më pak, se një shkelje e mundshme me shumë”.

5. Në rastet e ndaluara nga vendimi i Komisionerit nr. 213, datë 28.03.2023 veprimtaritë e raportuara nga bashkia Cërrik kanë qenë planifikuar si veprimtari publike (pjesëmarrja e komunitetit) dhe përmbanin indikacione të forta se ishin organizuar për të promovuar investime buxhetore (inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike, ndërtim banese Klos). Rrethanat e raportimit, në rastin më të pranueshëm, indikonin zhvillimin e një **veprimtarie publike të ndaluar për t'u promovuar** në kuptimin e nën-pikës 1.1 të pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020. Për këtë, administratës së KQZ-së do i duhej të verifikonte paraprakisht, nëse investimet publike që do inspektoheshin, ishin në kushtet që për to ishin *“vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo ishin transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”*.

6. Rezulton e provuar se bashkia Cërrik nuk ka depozituar ankim në KAS ndaj vendimit të Komisionerit nr. 213, datë 28.03.2023. **Vendimi i pa ankimuar dhe që ka hyrë në fuqi duhet të zbatohet nga institucionet publike që mbartin detyrimin për raportim.** Veprimtaria e ndaluar nga KQZ-ja për t'u zhvilluar nuk duhet të zhvillohet. Përndryshe përgjegjësia administrative bie si mbi personin përgjegjës, ashtu dhe mbi titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite (pika 6 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor).

7. Rezulton e provuar, gjithashtu, se bashkia Cërrik ka vijuar me aktivitetet publike të parashikuara, edhe pse është marrë vendim nga Komisioneri për ndalimin e tyre. Personi përgjegjës për lejimin e zhvillimit të veprimtarive publike të datës 30 mars, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja, është z. Florenc Doka, sekretari i përgjithshëm i bashkisë Cërrik, për shkak se ai është personi i caktuar përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike. Duke qenë person i ngarkuar me detyra nga Kodi Zgjedhor, sekretari i përgjithshëm i bashkisë Cërrik duhet të sanksionohet sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.
8. KAS vlerëson se edhe kryetari i bashkisë Cërrik gjendet në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, për aq kohë sa ka lejuar zhvillimin e veprimtarive të konsideruara të ndaluara nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pretendimi i sekretarit të përgjithshëm të bashkisë Cërrik se kryetari i bashkisë nuk ka marrë dijeni lidhur me njoftimin për ndalimin e zhvillimit të aktiviteteve nuk është i besueshëm, për pasojë nuk e çliron kryetarin e bashkisë nga përgjegjësia, sipas nenit 7 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik. Për shkak se kryetari i bashkisë nuk bën pjesë në rrethin e personave të ngarkuara me detyra nga Kodi Zgjedhor, kryetari i bashkisë Cërrik, për mosveprimin e tij, duhet sanksionuar me masë administrative sipas nenit 171, pika 2 *“Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.”*

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Florenc Doka, Sekretar i Përgjithshëm i bashkisë Cërrik.

2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Florenc Doka, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrrik, në masën 5 000 (pesë mijë) Lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Andis Salla, kryetar i bashkisë Cërrrik, në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) Lekë, sipas nenit 171, pika 2, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Mendim paralel)

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e kërkesës nr. 12 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt *“Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Cërrik”*, pavarësisht vendimmarrjes së KAS, ndaj opinion paralel në lidhje me argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) në lidhje me sanksionin administrativ të Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Cërrik, po ashtu ndaj mendimin që për këto aktivitete duhet të ishte vendosur sanksion administrativ edhe ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë.
2. Rezulton i provuar fakti se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të vendimit nr. 213, datë 28.03.2023, ka vendosur ndalimin e zhvillimit të veprimtarive publike me datë 30 mars, me temë:
a) *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, me vend të zhvillimit në *“Shales, NJA Shales”*, b) *“Ndërtim banese Klos”*, me vend të zhvillimit në *“Klos”*, c) *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, me vend të zhvillimit në *“Shtepanjë”*, ç) *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, me vend të zhvillimit në *“Shtermen”*, me arsyetimin se ***“aktivitetet e zhvilluara nga institucioni publik, Bashkia Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik, me pjesëmarrjen e personave partiakë përbën veprimtari të ndaluar, në kuptim të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”***.
3. Pavarësisht ndalimit të KSHZ për zhvillimin e këtyre aktiviteteve, nga denoncimet në KQZ se këto aktivitete janë kryer. Në lidhje me sanksionimin e zhvillimit të këtyre aktiviteteve jam i mendimit se ato nuk janë në shkelje të ligjit vetëm se i ka ndaluar KSHZ, por edhe për shkak të faktit që sipas legjislacionit në fuqi janë aktivitete të ndaluara për shkak të parashikimit të legjislacionit zgjedhor në fuqi.
4. Në aktivitetin *“Takim me banorët e lagjes së “Trokallinjve” në fshatin Shalës”*, kryetari i bashkisë Cërrik, njëkohësisht dhe kandidat për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, në fjalën e tij ka artikuluar se *“... pasi e kemi bërë brenda 6-mujorit të fundit edhe këtë pjesë, edhe me këtë zonë këtu patjetër*

që duhet të mbyllim edhe ciklin e plotë për pjesën e asfaltimit të rrugës, ujësjellësit patjetër, por edhe me Qeverinë Shqiptare, siç e përmenda më lart që kemi bërë të mundur edhe një pjesë të hapësirave toka bujqësore për kanalet vaditës, pasi është dhe një sektor shumë i rëndësishëm, që mbi 70% e ekonomisë së bashkisë Cërrik jemi nëpërmjet bujqësisë. Sot jemi në rrugën, patjetër që brenda pak ditësh edhe ne marrim pjesën e fundit për asfaltimin e kësaj rruge për të përmbyllë gjithë ciklin, kemi akoma disa punë të vogla për të arritur edhe pjesën e asfaltimit. Por është një premtim i mbajtur edhe banorët e presin, sepse realisht për 30 vjet duke kërkuar vazhdimësi, por për shkaqe edhe ekonomike dhe të problemeve me të cilët hasemi sot ne arrijmë që ta përmbyllim këtë cikël të rëndësishëm për të gjithë banorët”. Në po të njëjtin aktivitet ka qenë i pranishëm edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, z. Damian Gjijnuri, i cili në fjalën e tij ka artikuluar se “Mua më vjen mirë që Andi ka hapur një sërë kantieresh gjithë këto kohë, po bën punë të mira. Nuk është rastësi pse ne e rizgjodhëm kandidat për të drejtuar Bashkinë e Cërrikut pikërisht për këto gjëra. Se bashkia këto punë duhet të bëjë, rrugët e fshatit, sistemimet, punët e tjera të mëdha do t’i bëjë qeveria. Prandaj ne lidhim mirë dhe qeverinë dhe bashkinë. Në do sjellim projektet e mëdha, siç ishte dhe rasti i kanalit vaditës i cili është bërë me fonde të qeverisë, Djali e bëri rrugën, e me thënë të drejtën super rrugë edhe kur të asfaltohet. Tashti të tjerat, tashti PS do t’i bëjë këto gjëra, kush do t’i bëjë? Ç’a do bëjnë ata kundërshtarët?”.

5. Në aktivitetin “Takim me banorët e fshatit Shtëpanjë në Njësinë Administrative” kryetari i bashkisë Cërrik, njëkohësisht dhe kandidat për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, në fjalën e tij ka artikuluar se “... për shkak të terrenit që ka, është në një terren pak të vështirë, dhe ne pas elektrifikimit të energjisë elektrike nga qeveria shqiptare na u desh që , edhe mbas dëgjësave publike që kemi bërë me banorët, të arrinim që të fillonte puna për ta asfaltuar gjithë këtë aks. Është një punë që e kemi filluar para pak muajsh. Jemi në proces e sipër pune dhe brenda pothuajse pak ditësh ne arrijmë edhe asfaltimin e gjithë këtij aksi”. Në po të njëjtin aktivitet ka qenë i pranishëm edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, z. Damian Gjijnuri, i cili në fjalën e tij ka artikuluar se “Megjithëse kjo ska mbaruar, por siç e tha Kryetari, kjo punë nisi e s’do të ndalet. ... Më vjen mirë që Kryetari e mbajti këtë premtim. Jo më kot ne e kemi rikandiduar ... Ju e keni parë vetë dorën e pushtetit, investimet e qeverisë që kanë të bëjnë me

energjinë elektrike, këto që po bën Andi. Ne si qeveri shqiptare dhe si Parti Socialiste me përfaqësuesin tonë, do ta mbështesim vazhdimisht Cërrikun edhe me punë të tjera. ... Gjërat e mëdha do t'i marrë përsipër qeveria ... Shpresoj që t'ia shpërbleni (Andit). Pse? Që edhe ne të ndihemi mirë. Pra kur themi ore bëjmë diçka, japim një premtim, e realizojmë. Njerëzit ta vlerësojnë ta shpërblejnë. Sikur na fut në borxh. E keni parasysh popullin kur thotë: më ke vënë në borxh me sjelljen e mirë. Duke na vënë në borxh me mbështetjen për Andin, edhe mua më fusni në borxh politik që të shkoj nesër tek Edi Rama. Ore këta janë njerëz mirënjohës, ne bëjmë diçka, hajde të bëjmë edhe më shumë. Dhe unë besoj që këto janë veprat e para. Është si ajo paradhënia që ka bërë Andi ndaj jush dhe besoj që do ta marrim mbështetjen e fshatit në këto zgjedhje, që nuk është vetëm mesazh për Andin, por është dhe për ne të tjerët. Kështu që unë nuk më mbetet që tjetër vetëm të uroj që ta mbarojmë sa më shpejt këtë. Tani banorët e dinë vetë. Ky e dha një premtim, e mbajti. Tashti është rradha juaj, ky do të vazhdojë me pjesën tjetër, e kështu dhe jeta bëhet dhe më e mirë”.

6. Në aktivitetin “Në Njësinë Administrative Gostimë. Takim me banorët e fshatit Shtërmën për t’u njohur nga afër me problematikat e tyre” ka qenë i pranishëm edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, z. Damian Gjikhuri, i cili në fjalën e tij ka artikuluar se “Kryetari i Bashkisë bën punën e vet, miradministron taksat e qytetarëve, qeveria e ndihmon me këto investimet e tjera ... Unë dua ta falenderoj Andin për këtë premtim të mbajtur, dhe jo më kot ne e kemi rikandiduar dhe kërkojmë mbështetjen e gjithë fshatit për këtë djalë, sepse ky e ka treguar me vepra ... Ky nuk është vetëm, ky ka edhe Qeverinë e Edi Ramës nga mbrapa që e mbështet, më ka mua, ka edhe deputetin, Çimin, që e keni edhe atë djalin tuaj, njohës i mirë i zonës. Pra jemi një ekip politik i plotë, nuk jemi thjesht një individ. Këtu është një ekip i plotë politik që do të bëjë më të mirën për Cërrikun dita – ditës ...”
7. Siç rezulton nga përmbajtja e fjalimeve në aktivitetet e sipërcituara që janë organizuar nga Bashkia Cërrik, janë mbajtur fjalime me përmbajtje politike dhe elektorale nga përfaqësuesi politik i PS në Elbasan apo dhe nga vetë Kryetari i Bashkisë Cërrik.

Komisioni Rregullator pranë KQZ, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga nenet 90 dhe 92 të K.Zgjedhor, ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Në nenin 1 të këtij vendimi që përcakton qëllimin dhe objektin e tij, Komisioni Rregullator, ka përcaktuar se ky akt normativ është nxjerrë “... **me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake**”. Në nenin 7 shkronjat “dh” dhe “e” të këtij vendimi ku parashikohen detyrat e sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve publike, të pavarura e të varësisë, ndër të tjera parashikohet se “1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë: ... **dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike, në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse; e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e: ... v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore**”.

Ndaj unë i qëndroj opinionit që është e qartë që shfrytëzimi i aktiviteteve të organizuara nga Bashkia Cërrik për përcjelljen e mesazheve elektorale propagandistike apo për të anatemuar kundërshtarin politik të partisë politike që ka mbështetur dhe mbështet kryetarin e bashkisë në detyrë, cënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje. Nëse një sjellje e tillë e një kryetari bashkie nuk do të konsiderohej në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një akt normativ të pazbatueshëm. Po në të njëjtin përfundim do të dilej edhe në lidhje me nenin 91 të K.Zgjedhor nëse do të

pranonim që aktivitete si ato të organizuara nga Bashkia Cërrik nuk cënojnë sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Është alogjike të mendosh se një aktivitet i organizuar nga Bashkia Cërrik, mund të organizohet pa përdorur asnjë burim të saj, në kuptim të burimeve sipas nenit 91 të K.Zgjedhor. Dy janë mundësitë për të organizuar aktivitete të tilla: 1. Aktivitet i organizuar nga Bashkia Cërrik dhe që ka përdorim të burimeve të Bashkisë Cërrik; ose 2. Aktivitet politik i kandidatit për Bashkinë Cërrik me burime që duhet të deklarohen nga partia politike që e mbështet ose vetë kandidati në kuptim të fushatës zgjedhore. Një aktivitet me status të ndryshëm nga këto më sipër, nuk mund të ketë ku organizator të jetë Bashkia Cërrik apo Kryetari i Bashkisë Cërrik.

8. Për sa më sipër, në ndryshim nga shumica e anëtarëve të KAS, unë ndaj mendimin se sanksionimi i Kryetarit të Bashkisë Cërrik dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Cërrik nuk duhet të bazohet vetëm në faktin se aktiviteti është ndaluar paraprakisht nga KSHZ, por edhe se vetë natyra e aktivitetit është e tillë që është i ndaluar nga K.Zgjedhor dhe nga vendimi i sipërcituar i Komisionit Rregullator.
9. Po ashtu, në rastin objekt shqyrtimi duhet të ishte sanksionuar administrativisht edhe Partia Socialiste e Shqipërisë në zbatim të nenit 172 pika 1 e K.Zgjedhor, për atë kohë sa nga propaganda elektorale e kryer në këto aktivitete, është favorizuar pikërisht Partia Socialiste e Shqipërisë.

Anëtar: Ledio Braho